



REPUBLIKA E SHQIPËRISË
KËSHILLI I MINISTRAVE
KËSHILLI KOMBËTAR I TERRITORIT

V E N D I M

Nr. 26, datë 10.06.2021

P Ë R

MIRATIMIN E NDRYSHIMEVE NË PROJEKT GJATË NDËRTIMIT TË OBJEKTIT:
“KOMPLEKSI TURISTIK “THYMUS”, ME VENDNDODHJE NË DHËRMI, BASHKIA
HIMARË” DHE NDRYSHIMIN E SUBJEKTIT ZHVILLUES

Në mbështetje të neneve 27, 28 dhe 48 të Ligjit Nr. 107, datë 31.07.2014 “Për planifikimin dhe zhvillimin e territorit”, i ndryshuar; neneve 13, 17, të VKM-së Nr. 408, datë 13.05.2015 “Për miratimin e rregullores së zhvillimit të territorit”, i ndryshuar, si dhe VKM-së Nr.519, datë 20.09.2017 “Për përcaktimin e përbërjes së Këshillit Kombëtar të Territorit”, i ndryshuar, me propozim të zhvilluesit Z. Ilir Trebicka, Këshilli Kombëtar i Territorit,

V E N D O S I:

1. Të miratojë ndryshimet në projekt gjatë ndërtimit të objektit: “Kompleksi turistik “Thymus”, me vendndodhje në Dhërmi, Bashkia Himarë”, miratuar me Vendimin Nr. 17, datë 23.10.2019, të Këshillit Kombëtar të Territorit.
2. Të miratojë ndryshimin e subjektit zhvillues të objektit “Kompleksi turistik “Thymus”, me vendndodhje në Dhërmi, Bashkia Himarë”, nga Z. Ilir Trebicka, në shoqërinë “Drimadhe I & I” sh.p.k.
3. Harta e Planvendosjes së Strukturave, miratuar me vendimin e Këshillit Kombëtar të Territorit Nr.17, datë 23.10.2019, zëvendësohet me Hartën e Planvendosjes së Strukturave bashkëlidhur këtij vendimi.
4. Ngarkohet Agjencia e Zhvillimit të Territorit në bashkëpunim me Ministrinë e Turizmit dhe Mjedisit për zbatimin e këtij vendimi.
5. Ky vendim hyn në fuqi menjëherë.

K R Y E T A R I


EDI RAMA



MINISTËR I LINJËS

MINISTËR I TURIZMIT DHE MJEDISIT

BLENDI KLOSI



ANËTAR / SEKRETAR I KKT

DREJTOR I AGJENCISË SË ZHVILLIMIT TË TERRITORIT

LEDIA TOTA

